

KERKESE PER KONSULTIM ME PUBLIKUN

Drejtuar: AKM-se Tirane
Per dijeni: DRM-se Fier

RRITJE INTESIVE E GJEDHIT NE NJE INSTALIM



*Instalimi –Rritje intensive e gjedhit, bazuar ne shtojcen I te ligjit Nr. 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, “Per lejet e mjedisit”, te ndryshuar klasifikohet si aktivitet: **Blegtoria 7.8 d. Rritje intensive e gjedhit ne nje instalim.***

Vendodhja: Qyteti Divjake, Bashkia Divjake.

Zhvilluesi:

Personi Fizik Andi Kokoneshi

Nr. kontakti
0695739800

Maj 2021

FERMA
KOKONESH I
NR. NIPTI
L83902403-S

Hyrje

Kerkesa per pjesmarrjen ne organizimin e konsultimit me publikun dhe palet e interesuara hartohet per aplikim per leje mjdisi tipi B, **Blegtoria 7.8 d. Rritje intensive e gjedhit ne nje instalim**, Me kapacitet me shume se 50 (njesi) vende gjedhi, bazuar kjo ne shtojcen 1 te ligjit Nr. 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar.

Ky aktivitet zhvillohet nga personi fizik Andi Kokoneshi i regjistruar ne QKB, me numer NUIS L83902403S me fushe veprimtarie "Stalle lope per prodhim qumeshti.

Vendodhja e stalles eshte ne qytetin e Divjakes, Bashkia Divjake me Nr. Pasurie 210/6 dhe 210/7 ZK 1492.

VENDODHJA FERMA "KOKONESHI"



Objekti ndodhet ne Njesine Strukturore B1-19
Bashkia Divjake
Sistemi B_Bujqesor
Perdorime te lejuara B1. Aktivitetite Ekonomike dhe Bujqesore
Kategoria 1 B.Zona Bujqesore

Objekti “Stalle per rritjen intesive te gjedhit” ndodhet ne territorin e Parkut Kombetar Divjake-Karavast, e cila ben pjese ne Kategorine II te zonave te mbrojtura.
Bazuar ne ligjin Nr.81/2017 “Per zonat e mbrojtura” Neni 16 Parku Kombetar (Kategori II) Pika 4 lejohet kryerja e ketij aktiviteti duke ju permbajtur kushteve te lejes qe do te miratohet.

NJESIA STRUKTURE B1-19




6/2/2021, 10:54:54 AM


— Bregdetar — INT.Infrastruktura Transporti

Njësiti Strukturore

■ B.Toke Bujqesore



Koordinatat e objektit jane:



Nr	X (East)	Y (Nord)
Pika 1	458462.385	4541782.417
Pika 2	458411.967	4541758.928
Pika 3	458526.995	4541650.146
Pika 4	458477.285	4541629.628

KUADRI LIGJOR

Ne vijim te raportit do te njihemi me ligjet baze te cilat detyrojne me forcen ligjore mbrojtjen e mjedisit. Subjeti zhvillues eshte ne zbatim te hapave ligjore.

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndyshuar

Ligji Nr. 52/2020, per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar.

Ligji Nr. 10440, date 23/01/2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji Nr. 12/2015 date 26.2.2015 Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10 440, date 7.7.2011, "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji Nr. 10448, date 14/07/2011 "Per lejet e mjedisit",

Ligji Nr.8897, date 16/05/2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"

Ligji Nr.9010, date 13/02/2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"

Ligji Nr.9587, date 20/07/2006 "Menaxhimin e integruar te burimeve ujore "

Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", ndyshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.

Ligji Nr. 8405, date 17/09/1998 "Per urbanistiken" ndryshuar me ligjet Nr. 8453, date 04/02/1999 dhe Nr.8991, date 23/01/2003 dhe Nr.8682, date 07/11/2000"

Ligji Nr. 8652, date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore."

Ligji Nr. 9244, date 17/06/2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore"

Vendime te Keshillit te Ministrave (VKM) dhe udhezime

VKM Nr.249, date 24.04.2003 "Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te elementeve te lejes mjedisore"

VKM Nr.268, date 24.04.2003 "Per certifikimin e specialisteve, per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe te auditimit mjedisor."

VKM Nr.805, date 4.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore.

VKM Nr.24, date 22.01.2004 "Per veprimtarine e inspektoriatit te mjedisit"

VKM Nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret.

VKM Nr.686, date 29.7.2015 per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (vnm) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore.

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.3, date 17.08.2004 "Per miratimin e listes se veprimtarive, formatimin e aplikimit, dhe rregullat e procedurat e dhenies se pelqimit dhe autorizimit mjedisor nga ARM.

Rregullore e Ministrise se Mjedisit Nr.1, date 17.08.2004 "Per pjesemarrjen e publikut ne procesin e vleresimit te ndikimit te mjedis."

Udhezimi i Ministrit te Mjedisit Nr.5, date 28.12.2007 "Per tarifat e sherbimit per Leje Mjedisore.

Udhezimi Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie."

Udhezim i Nr.2, date 21.05.2007 "Per miratimin e listes se veprimtarive me ndikim ne mjedis, menyren e aplikimit dhe rregullat e provedurat e dhenies se autorizimit dhe pelqimit mjedisor nga Agjencite Rajonale te Mjedisit."

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.1, date 07.01.2008 "Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore.

Urdher i Ministrit te Mjedisit, Nr.429, date 17.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per pajisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit.

Gjate vitit 2011, jane miratuar edhe tre ligje te rendesishme per mjedisin:

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit"

Ky ligj eshte plotesisht i perafruar me Direktiven 2004/35/KE te Parlamentit European dhe Keshillit, date 21 Prill 2004 "Mbi pergjegjesite mjedisore, parandalimin dhe riparimin e demeve te mjedisit" te ndryshuar"

Ligji Nr.10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ky ligj eshte perafruar plotesisht me Direktiven 85/337/KEE te Keshillit, date 27 Qershor 1985 "Mbi vleresimin e efekteve te projekteve publike dhe private ne mjedis", te ndryshuar.

Ligji Nr. 10448, date 17.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit" Ky ligj eshte perafruar plotesisht me

Direktivat:

2008/1/KE e Parlamentit European dhe Keshillit e 15 janarit 2008 "Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar te ndotjes", e ndryshuar

Direktiven 2001/80/KE e Parlamentit European dhe Keshillit e 23 Tetorit 2001 "Mbi kufizimin e shkarkimeve te disa ndotesve ne ajer nga instalimet e medha me djegie"

Te tre keto ligje nuk kane hyre ende ne fuqi pasi eshte duke u pergatitur aktet e nevojshme nenligjore. Keto tre ligje hyjne ne fuqi ne Shkurt te vitit 2013

PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Ferma “Kokoneshi” me vendodhje ne qytetin e Divjakes operon ne fushen e rritjes intensive te gjedheve per prodhimin e qumeshtit.

Qellimi i ketij aktiviteti eshte rritja intensive e gjedheve per prodhimin e qumeshtit duke furnizuar tregun ne rajonin e Shqiperise.

Ky aktivitet zhvillohet ne nje siperfaqe totale rreth 7534 m² te ndertuar me te gjitha instalimet dhe infrastrukturen e nevojshme per rritjen e gjedheve.

Sheshi dhe objekti eshte organizuar ne menyre te tille:

- 2 ambjente ne funksion te bujqesise 1-kateshe
- Stalle 1 kateshe
- Vendparkim i mjeteve
- Hangar bari i mbuluar
- Grope plehu
- Silazh



Stalla eshte organizuar me nje koridor ne mesin dhe ne te gjithe gjatesine e objektit i cili krijon lehtesira per hedhjen e ushqimit me ane te unifees, etj. Ne te dyja anet e koridorit ndodhet zona e ushqimi ku sistemohen kafshet per tu ushqyer. Stalla eshte ndertuar me konstrukcion metalik dhe eshte mbuluar me mushama transparente e cila hapet dhe mbyllet sipas nevojave te drites, eres, shiut, etj. Ventilimi eshte nje faktor shume i rendesishem per mbajtjen paster te stalles per uljen e temperatures se ambientit, per pastrimin e ajrit dhe per rritjen e prodhimtarise se qumeshtit pasi ndikon drjetperdrejte ne shendetin e kafsheve dhe performancen e tyre.

Stallat e rritjes intensive te gjedhit eshte ndertuar ne menyre te tille, e leversidshme nga ana ekonomike, e pershtatshme per kafshet, funksionale dhe me hapsire te mjaftueshme per kryerjen e funksioneve te aktivitetit ku perfshihet dhe impinti i mjeljes se kafsheve.

✚ Ajri

Sa me te uleta te jene temperaturat e ambientit ku rine lopet aq me i larte eshte dhe rendimenti i qumeshtit. Stalla eshte ndertuar ne menyre te tille qe temperatura e brendshme e nderteses te kete te njejten tempertaure me ajrin e ambientit. Kur temperaturat e jashtme jane te larta, kryesisht gjate periudhes se veres, freskimi i ambientit te stalles behet me ane te qarkullimit te ajrit. Ne vere ajri qarkullon nga 40 deri ne 60 here ne ore dhe ne dimer 4 deri ne 6 here ne ore. Qarkullimi i ajrit eshte i nevojshem sepse vetem keshtu shmanget lageshtia, nxehtesia dhe krijimi i mikroorganizmave te demshme ne stalle. Nese ajri i konsumuar nuk del shpejt nga stalla, kjo sjell probleme tek kafshet. Tek stallat me ajrosje te lire, eshte pasur parasysh qe ndertesa te ndertohet ne drejtim te eres me qellim qe ne te mund te qarkulloje ajer i paster. Lopet nuk jane te ndjeshme ndaj ajrit te ambientit. Lopet durojne nje shpejtesi ere prej 3 deri ne 5 m/sec, ne vere ato jane te varura nga qarkullimi i ajrit, duke shmangur stresin e shkaktuar nga temperaturat e larta.

✚ Drita

Testime te shumta treguan qe kohezgjatja e dites dhe intensiteti i drites ndikojne ne rendimentin e qumeshtit. Optimale eshte 14 deri ne 16 ore ne dite. Duke e pare nga ana ndertimore, kjo do te thote qe mbulesa e stalles mundeson nje shfrytezim optimal te drites natyrore dhe behet i mundur nje menaxhim i duhur i drites me intensitet prej afersisht 200 lux.

✚ Zona e ndenjjes

Koha e fjetjes prej 12 oresh dhe me shume, ben te mundur nje ripertypje intensive, kjo eshte e lidhur me sekrecionin e peshtymes. Gjate gjumit qarkullimi i gjakut ne gjinjte e lopes behet me intensiv dhe kjo permireson sintetizimin e qumeshtit. Nje aspekt tjetër i rendesishem qe arrihet gjate gjumit eshte lehtesimi i thundrave, i tendinave dhe kyçeve. Nese arrijme qe t'i ofrojme lopes kushtet e kullotjes, pra hapësirën, sipërfaqen e nevojshme dhe qetësinë e saj, atëherë ajo mund të realizojë 12 ore gjume.

✚ Vendi i fjetjes

Vendi i fjetjes luan vetem nje rol dytesor mjafton qe te jete i bute, i thate dhe i ajrosur mire. Shtreterit jane te ngitur 15 cm te larte dhe te mbuluar me kashte te imet dhe te thare mire. Here pas here behet pastrimi dhe nderimi i shtrojës ne menyre te tille qe te sigurohet pastertu per kafshen.



Foto 1 Vendi i fjetjes se gjedhit

✚ Korridoret

Per te arritur rendiment optimal te qumeshtit lopet kane nevojte per dalje te lire tek ushqimi i fresket per gjate 22 oresh. Korridoret jane planifikuar duke iu pershtatur automatit te ushqimit (shtresa beton) Dimensionet e korridorit jane te tilla qe te lejojne relativisht levizjen e lire te kafsheve dhe te pajisjes se ushqimit.



Foto 2 Ushqimi i gjedhit

✚ Grazhdi

Grazhdi eshte me i larte se vendi ku lopa rri, me qellim qe lopa te mund te haje duke ulur dhe nxjerre koken para. Grazhdi eshte ne nje siperfaqe te lemuar dhe te ndriçuar (afersisht 1 meter mbi zonen e grazhdit), sepse gjuha e lopes eshte veçanerisht e ndjeshme edhe ndaj aromave.

✚ Uji

Lopet kane nevojte per 4 deri ne 5 liter uje per çdo kg qumesht te prodhuar. Furnizimi me sasine e nevojshme me uje eshte nje nga premisat kryesore per nje rendiment te larte qumeshti. Per çdo grup lopesh duhet te kete te pakten 2 mundesi per te pire uje. Per ato lope te cilat duan te pijne ne korita, kujdesemi qe keto te mos mungojne dhe te mos vendosen ne cepa ose rruge qorre por ne pozicione te tilla ku dhe pastrimi i tyre te jete i lehte dhe i shpejte. (korita qe mund te permbysen).

PLANI I VENDOSJES SE STRUKTURES

OBJEKTI : "STALLE PER MBARSHTIMIN E LOPEVE PER PRODHIMIN E QUMESHITIT DHE AMBIENTE NDIHMESE", QYTETI DIVJAKE, BASHKIA DIVJAKE.



SHKALLA 1:500

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISE DIVJAKE

Fredi Kokoneshi

Digitally signed by Fredi Kokoneshi
Date: 2018.10.19 14:08:56 +0200

Treguesit e zhvillimit te propozuar

SIP TOTALE E TOKES : 7534 M²
 SIP E TOKES PASURISE NR. 210/8 : 1840 M²
 SIP E TOKES PASURISE NR. 210/7 : 5694 M²
 SIP TOTALE E NDERTIMIT : 2705 M²
 SIP E STALES + ZYRARE : 1775 M²
 SIP E HANGARIT : 440 M²
 SIP E VENDPARKIMIT : 480 M²
 KOEFICENTI I SHFRYZIMIT TE TERRITORIT : 36 %
 INTESITETI I NDERTIMIT : 0.36
 NUMRI I KATEVE MBI TOKE : 1
 NUMRI I KATEVE NEN TOKE : 0
 LARTESIA TOTALE E OBJEKTIT : 9.25 M
DISTANCAT NGA AKSI RRUGES:
 VERI: 11.40 M dhe 19.00 M NGA AKSI I RRUGES
DISTANCAT NGA KUFIRI I PRONES:
 VERIU: 9.80 M NGA KUFIRI I PRONES
 LINDJA: 1.00 M NGA KUFIRI I PRONES
 JUGU: 0 M NGA KUFIRI I PRONES
 PERENDIMI: 0.5 M NGA KUFIRI I PRONES
DISTANCAT NGA OBJEKTE T FQJNE:
 LINDJE: 4.50 M NGA OBJEKTI
 PERENDIMI: 10.00 M NGA OBJEKTI

OBJEKTI : "STALLE PER MBARSHTIMIN E LOPEVE PER PRODHIMIN E QUMESHITIT DHE AMBIENTE NDIHMESE"


DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
LAZAR VODO

Llazar Vodo
Digitally signed by Llazar Vodo
Date: 2018.10.19 14:08:23 +0200

PROJEKTUES: C.E.C. GROUP SH.P.K

Vangjush Mbricci
Digitally signed by Vangjush Mbricci
Date: 2018.10.19 14:03:22 +0100

ZHVILLUES: ANDI KOKONESHI



Proceset teknologjike ne instalim

Proceset kryesore teknologjike ne “Fermen Kokoneshi” kryesisht jan dy:

- ✚ Prosesi i pare i cili realizohet me anen e nje paisje qe quhet UNIFEED qe sherben per te pergatitur dhe servitur ushqimin kafsheve. Kjo paisje merr me ane te nje freze te posacme ushqimet e silazhuara, silazh misri, silazh jonxhe, lolium te thate, si dhe koncentratet e dritherave (miser, elb, soje, premix) dhe pasi i perzien i serviren kafsheve per konsum.



Foto 3 Paisja UNIFEED

- ✚ Prosesi i dyte eshte ai i mjeljes se kafsheve qe realizohet nepermjet dhomes se mjeljes. Gjat ketij procesi dergohet qumeshti nepermjet nje linje apostafat nga vendi i mjeljes ne tankun (frigorifer) ftohes. Qumeshti qendron ne ftohes ne temp. 3°C deri ne momentin qe e merr fabrika.



Foto 4 Dhoma e mjeljes



Foto 5 Tangu ftohes

Lendet e para:

- ✓ Jonxha 40 ha
- ✓ Misri 20ha
- ✓ Elbi 20ha

Lendet ndihmese:

- ✓ Energji elektrike
- ✓ Uje

Kapaciteti i gjedhit 200 cope

Produkti perfundimtar eshte qumeshti sasia rreth 2000 litra



Foto 6 Ambjentet e jashteme te stalles

Infrastruktura e nevojshme

- ✓ Rrjeti elektrik eshte i lidhur ne kabinen e fermes. Kabina me emer Andi Kokoneshi eshte linje private, me nje gjatesie prej 2000 m dhe lidhet me rrjetin elektrik shteteror ne afersi te kabines se quajtur ferma 02.



Foto 7 Kabina elektrike

- ✓ Furnizimi me uje kryhet nepermjet nje pusi te ndodhur brenda territorit te fermes. Subjekti eshte ne procedura te paisjes me leje shfrytezimi te pusit me autoritetet ne Basenin Ujor Seman.

Nipt : L83902403S
E-Mail : Andikokoneshi07@gmail.com
Tel : 0695739800

ZYRA E ADMINISTRIMIT TE
BASENIT UJOR
SHKUMBIN-SEMAN
Nr. 220 Prot.
Datë.më 02.04.2021

Data : 02/04/2021

KERKESE


Drejtuar: Agjensia e Basenit Ujor Seman , me adrese Fier

Objekti : Kerkese per pajisje me ' Leje shfrytezimi burimi uJOR { pus I hapur ne vitin 2015}

I nderuar,
Andi Kokoneshi PF me NIPT : **L83902403S** me ushtrim aktiviteti: Ferme Blegtorale mbarshtrim te lopeve per prodhimtari qumeshti me Adrese Rruga e Kularit Divjake me nr pasurie 210/7, nga ana e institucionit tuaj ne kerkojme qe tna informoni per dokumentat e nevojshme per paisjen me leje shfrytezimi te burimit ujore, dhe ndjekjen e te gjitha procedurave per perfitim e kesaj leje .

Duke ju falenderuar jemi ne pritje te pergjigjes tuaj.

Administratori :
Andi Kokoneshi



**FERMA
KOKONESHI
NR. NIPTI
L83902403-S**

PERSHKRIMI I RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETI

➤ Shtrirja Gjeografike

Objekti “ Stalle per rritjen intesive te gjedheve” ndodhet ne veri-perendim te qytetit te Divjakes, ne zonen kadastrale ZK 1492, Nr. Pasurie 210/7.

Bashkia Divjake shtrihet ne pjesen qendrore te Shqiperise dhe kufizohet ne veri me bashkine e Kavajes ne lindje me bashkine Lushnje, ne jug me bashkine Fier dhe ne perendim me Detin Adriatik. Bashkia ka nje siperfaqe prej 309.58 km² dhe kryeqendra e saj eshte qyteti i Divjakes. I gjithe territori perbehet kryesisht nga zona rurale, te cilat kane shtrirje veri-jug. Bashkia Divjake perbehet nga pese njesi administrative te cilat jane; Divjak, Terbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas. Ne planin gjeomorfologjik bashkia e Divjakes paraqet nje vazhdimesi territoriale te zones perendimore te Divjakes dhe pjeses jugore te bregdetit Adriatik. Zona kodrinore perendimore e Divjakes kane te njejten morfologji dhe zhvillimi i tyre ne te ardhmen duhet pare si nje zhvillim rajonal, jo i shkeputur.

➤ Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues

Ne Divjake dallohet tre ekosisteme: Laguna se bashku me zonen kenetore dhe pyllin e Divjakes, sistemi kodrinor ne lindje te Bashkise dhe sistemi fushor ne lindje te sistemit kodrinor.

Laguna dhe pylli Divjakes

✚ Laguna Karavastase

Laguna e Karavastas eshte laguna me e madhe ne Shqiperi. Laguna ndahet prej detit nga pylli me pisha i Divjakes, e cila perbehet nga nje lagune e brendshme dhe nga laguna e vogel e jashtme. Laguna e Divjakes lidhet me detin Adriatik me tre kanale, njeri prej te cileve artifivial, i hapur per nevojat e peshkimit. Laguna e divjakes aktualisht eshte pjese e Parkut te Karavastase, i mbrojtur nga konveta e Ramsarit. Laguna per nga rendesia e sa nderkombetare, por dhe nga pasurite e shumta natyrore dhe ne habitate ku vlen te përmendet prania e pelikanit kacurel dhe flamengove, terheq gjithnje e me shume turiste nga vende te ndryshme te botes. Përvec pamjes dhe bukurive natyrore, laguna ofron dhe aktivitetin e peshkimit, aktivitet i cili menaxhohet nga nje shoqate private e ngritur nga vete peshkatarët e zones duke percaktuar kohen e duhur dhe sasine e caktuar te pehkimit ne kohe te ndryshme te vitit. Krahas bukurive natyrore dhe potencialeve qe mbart ne vete laguna, sot perballat edhe me probleme te cilat jane mjaft shqetesuese per bashkine dhe banoret. Per shkak te terheqjes se detit ne vitet e fundit laguna humbet here pas here komunikimin me detin, gje qe con ne mos furnizimin dhe nderrimin e ujit te saj. Fenomen ky qe ndikon drejtperdrejte ne habitatet qe bashkejetojne ne mardhenie te ndersjellte me lagunën.

Prania e lumenjeve Shkumbin dhe Seman:

Territori i Divjake kufizohet ne veri dhe ne jug nga elemente te larte territorial sic jane lumenjte. Shkumbini ne pjesen veriore dhe degezimi i Emisarit te Myzeqese ne pjesen jugore jane elemente qe kane ndikuar ne kohe drejteperdrejte ne permiresimin e cilesise se tokave bujqesore ne afersi te tyre. Ne shume raste banoret kane shfrytezuar burimin e ujit te ketyre resurseve per vaditje te tokave te punueshme. Ne te dy lumenjte kufizues te Divjakes egziton nje habitat lumore qe vitet e fundit po zhvillohet pozitivisht. Keta habitate mund te zhvillohen me teper nepermjet ruajtjes dhe mbrojtjes se tyre duke bere koridore te rendesishme per shpendet, gjitare dhe invertebroret.

Megjithate shfrytezimi i te mirave te ketyre burimeve nuk eshte i plot per shkak te shkalles se madhe te ndotjes nga mbetjet urbane apo bllokim si pasoje e shkarjeve te dheut. Nderhyrje minimaliste ne mirembajtjen e resurseve ujore do sillte benefite ne ekosistemin e zones, por njekohesisht dhe aktivite te ndryshme si peshkim apo lundrim. Ne territorin e Bashkise jane 17 rezervuare te cilet krijojne peisazhe piktoreske ne zone dhe ruajne habitate nga degradimi. Rezervuaret jane te lidhur me sisteme kanalesh vaditese, te cilat perdoren nga banoret e fshatrave perrethe. Fatkeqsisht, duhet permendur qe nje numer i madh i kanaleve jane te degraduar dhe aktualisht nuk perdoren. Nga inspektimet e bera ne vend vihet re ndotja dhe mungesa e mirembajtjes se rezervuareve. Nderhyrje te vogla do te rivitalizonin funksionin e tyre dhe njekohesisht krijonin hapsira me potencial terheqje vizitresh.

Pylli i Divjakes

Pylli i Divjakes per nga vete forma dhe permbajtja e tij, per pasurite qe mban ne vetvete, eshte nje nga habitatet me te rendesishme ne vend si nga aspekti ekologjik dhe nga ai turistik. Pisha e Divjakes e njohur ndryshe keshtu, mbledh ne gjirin e saj bukuri te rralla te cilat pak ose aspak mund ti hasesh ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe per vlerat e medha qe ajo ze ne aspektin ekologjik. Siperfaqja e pyllit eshte 1200 ha, nga 22.230 ha qe eshte e gjithe siperfaqja totale e parkut. Ne kete siperfaqe zhvillohet cdo dite dhe stine te vitit jeta shtazore dhe bimore. Lista e flores se kompleksit eshte e gjate por ajo qe bie me shume ne sy eshte prezenca e pishes se bute dhe asaj te eger (Pinus Pinea), nga edhe ky pyll ka mar emrin pylli me pisha. Ne brendesi te tij gjenden dy bime endemike te rralla e para eshte nje lloj orkide e quajtur (archis albanica) dhe nje hibrid ndermjet dy lloj orkidesh (Orchisxpoparistoi), te cilat gjenden vetem ne pyllin e Divjakes ne Shqiperi. Mozaiku i perbere nga pisha te buta dhe te egra, dellinja mersina, frasheri, lisi dhe shume lloje te tjera bimesh, krijojne nje peisazh unik. Pylli shekullor, rera kurative, deti, bota e gjalle natyrore, laguna, ofrojne ambinete per shetitje biciklete, piknik, shlodhje, plazh, stufime rreth flores dhe funes. Kompleksi i lagunes Divjake-Karavasta eshte me i rendesishmi ne Shqiperi ne terma gjeografike kombetar dhe nderkombetar.

Sistemi kodrinor

Kodrat e kultivuara- agrosisteme te rendesishme per habitatet dhe biodiversitetin. Pjesa Lindore e bashkise Divjake perbehet nga fshatra bujqesore te vendosur ne kodra. Pozita gjeografike me klime te favorshme dhe cilesi te larte te tokave bujqesore ka bere Divjaken nje nder bashkite me prodhimtari me te larte te frutave dhe perimeve. Modernizimi i mjeteve per kultivimin e kulturave bujqesore, ka lehtesuar punen e fermereve dhe ka rritur siperfaqen dhe sasine e prodhimit. Sipqerfaqe te medha toke jane zene vitet e fundit nga serrat te cilat kultivojne fidane dhe jane burimi me i madh ne te gjitha Shqiperine. Bujqesia si degezimi kryesor i bashkise Divjake zhvillohet privatisht nga banoret e zones ne sasi te medha me kapacitete dhe per eksport. Si rjedhoje e pamjeve peisazhike, bukurive natyrore dhe kushteve optimale per zhvillimin e bujqesise, zona lindore e Divjakes ka potencial per zhvillimin e metejshem te agro-turizmit.

➤ Popullsia, klima, hidrologjia dhe infrastruktura ekzistuese

-Popullsia

Sipas Censusit te vitit 2011, bashkia e Divjakes numeron nje popullsi prej 34.254 banoresh nderkohe qe ne regjistrin civil rezulton nje popullsi 53.372 vete. Territori i bashkise se re eshte 309.58 kilometra katrore. Ne baze te censusit, densiteti i popullise eshte 110 banore per kilometer katror ndersa ne baze te regjistrin civil densiteti eshte 172.40 banore/km².

Kjo bashki perbehet nga 5 njesi administrative, te cilat jane: Divjake, Terbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas. Te gjitha njesite administrative jane aktualisht pjese e rrethit te Lushnjes dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nen administrimin e saj nje qytet dhe 36 fshatra.

- Klima

Klima ne fushen bregdetare eshte tipike mesdhetare, me reshje mesatare te 893 mm ne Divjake. Rreshjet ne Divjake ne masen 70% deri 75% ndodhin nga tetori deri ne mars. Avullimi vleresuar nga te dhenat klimatologjike te stacionit te Vlores (Instituti Hidrometeorologjik 2001) te arrijne nje vlere vjetore prej 1200 mm. Edhe pse kjo ka nje deficit hidro-klimatike, kjo nuk eshte aq e rendesishme si ne fusha te tjera perendimore te Mesdheut. Kjo nenkupton se dhe ne pellgun e saj te kullimit laguna eshte perballur gjithmon sezonalitet te forte ne regjimin e saj te ujit dhe kripesi, sic eshte zakonisht rasti per lagunat bregdetare te Mesdheut.

Nje variabel i rendesishem klimatike per hidrologjine e lagunes eshte era, e cila lejon perzierjen e ujrave dhe rrit ose netralizon efektin batices ne shkembimet e ujit me detin. Gjate pranveres dhe veres, drejtimin e eres mbizoteruese eshte nga Veriu dhe Perendimi.

Table 1 Temperatura mujore mesatare, reshjet dhe evapotranspirimi ne Divjake.

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti
Temp (°C)	8.2	9.1	11	14.1	18.3	22.3	24.3	24.4	21.6	17.6	13.2	9.7	16.2
Prec. (mm)	117	103	87	81	66	35	25	34	57	93	146	119	963
Evap (mm)	49	55	66	85	110	134	146	146	130	106	79	58	1163

Temperaturat maksimum dhe minimum jane vrejtur ne muajt Gusht dhe Janar, nderkohe qe rreshjet me te vogla ne Gusht dhe me te medha ne Nentor. Evapotranspirimi me i larte ne Korrik dhe Gusht ndersa me-i ulet ne muajt e dimrit. Deficiti i lgeshtise, si ne gjithë zonen mesdhetare eshte ne sezonin e veres dhe vjeshtes deri ne muajin Nentor.

- Hidrologjia

➤ Ujrat nentokesore

Pjesa me e madhe e territorit te Bashkise Divjake, zona kodrinore qendrore dhe zona fushore-lagunore perendimore, nuk jane te pasura ne ujra nentokesore, perkundrazi zona fushore lindore (fusha e Lushnjes, pjesa e brendeshme e zones fushore e Bashkise Divjak- Cerme, Grabian, Terbuf, Grdishte dhe Remas) permban rezerva te rendesishme ujrash nentokesore.

Shtresa ujembajtese me perhapje te gjere dhe ujembajtje te larte

Shtresat ujembajtese lidhen me depozitimet zhavorrore qe mbushin luginen e fushen e Lushnjes. Keto shtresa kane parametra te mire hidrogjeologjike sikurse duket ne vlerat e tyre mesatare te dhena me poshte; Trashesia e shtreses zhavorrore 10-25m, Keoficienti i filtrimit rreth 50-150 m/dite; keoficienti i uje percjellshmerise rreth 500-2000m²; Prurjet specifike te puseve 4-5 deri 10-15l/sek/m; Prurje maksimale te puseve 10-50l/s.

Studimet e shumta hidrokimike kane treguar se ne gjysmen veriore te fushes (ne veri te qendres te ish kenetes se Terbufit) cilesia e ujerave nentokesore eshte e mire; ajo ploteson Standartet Shteterore per Ujin e Pijshem. Ne gjysmen jugore te fushes se Lushnjes cilesia e ujrave nentokesore prishet (rritet kripezimi i ujit dhe permbajtja e sqfurit per shkak te biodegradimit anaerob te shtresave te torfes ku prodhohet gaz sulfhidrik-H₂S) dhe ato jane te pa pijshme. Zona me e pershtateshme per te shfrytezuar ujerat nentokesore te shtresave ujembajtese zhavorrore eshte gjithë zona e Cermes. Rezervat e shfrytezueshme te ujrave nentokesore ne zonen e Cermes jane rreth 500l/s, por shfrytezimi i tyre

duhet barazpeshuar gjithashtu edhe me sasine e ujit qe pompohet ne Dushk per furnizimin me uje te Lushnjes.

Shtresa ujembajtese me perhapje te gjere dhe ujembajtje deri mesatare.

Keto shtresa ujembajtese lidhen me formacione konglomeratika-ranore te serise Rogozhina. Sikurse e pershkruam me siper ato zbulohen ne siperfaqe ne zonen kodrinore si dhe ndodhen nen depozitime kuaternare ne pjesen me te madhe te fushes se Lushnjes. Shtresar ujembajtese konglomeratike kane zaje shkembinjsh te ndryshem e te rrumbullakosur mire te cilat ne pjesen me te madhe jane e cimentuara. Konglomeratet permbajne dy tipe hapsirash ujembajtese te cilat jane carjet dhe hapsirat e krijuara nga tretja e cimentos karbonatike. Vende vende konglomeratet si dhe ranoret jane te cimentuara dobet dhe ne kete rast permbajne ujera poresh. Vlera mesatare te parametrave hidraulike te ketyre shtresave jane; Trashesia e shtresave ujembajtese 10-15 deri 30-40; Koeficienti i filtrimit rreth 2-3m/dite; Koeficienti i ujepercjellshmerise rreth 40-70m²/dite; Koeficienti i magazinimit 0.0005; Prurjet specifike te puseve 0.35-0.55l/sek/m; Ujrat nentokesore te shtresave ujembajtese te serise Rogozhina nuk jane shume te mira ne pikpamje cilesore. Keto ujera nentokesore jane zakonisht te forta, dhe shpesh permajne hekur ne sasi te larte.

Shkembine praktikisht pa ujera nentokesore

Pjesa me e madhe e zones fushore-lagunore perendimore perbehet kryesisht nga formacione argjilore dhe ranore te cilat praktikisht nuk permbajne ose permbajne pak deri aspak ujera nentokesore. Ne keto formacione nuk ka burime si dhe ne to nuk vendosen puse per uje. Sasira te vogla ujrash nentokesore ndodhen veten ne mbuesat kuaternare te perfaqesuara kryesisht nga rera bregdetare. Keto ujra nentokesore shfrytezohen me puse fshatare me diameter te madh ose truma.

➤ Ujrat siperfaqesor

Territori i Bashkise ndodhet ne mes te dy rrjedhave te rendesishme ujore; **Lumenjt Shkumbin** ne (veri) dhe **Seman** (ne jug). Ujitja por dhe furnizimi me uje te thelle (aquifere/hidrologjike) i zones behet nga uji i ketyre lumenjeve. Kanalet ujitesse marrin uje ne lumenjte Shkumbin (Cerma dhe nje pjese e Divjakes) nepermjet tre pikave te marjes se ujit (Cerme, Sulzotaj dhe veri te Divjakes), ngarezervuari i Thanës me kapacitet rreth 30milion m³ llogaritur dhe ujin qe sjell Devolli ne rezervuar gjate gjithë vitit, nga rezervuari i Divjakes (ne sistemin kodrinor ne lindje te saj) dhe nga lumi Seman (Remas dhe nje pjese e Gradishtes).

Nga ana tjeter lumenjte Shkumbin dhe Seman diktojne vijen bregdetare dhe ate te Karavastase se bashku me kanalet qe e lidhin ate me detin.

Njesia hidrologjike me e rendesishme ne territorin e Bashkise se Divjakes eshte **laguna e Karavastase**. Siperfaqja e hapur ujore e lagunes se Karavastase eshte rreth 4330 ha; ajo ka nje thellesi

maksimale prej 1.5m dhe eshte e lidhur me detin permes tre kanaleve. Vetem kanali i veriut lidh drejtperdrejt lagunen e Karavastase me detin; kanalet qendrore dhe jugore lidhin lagunen e Karavastase me nje lagune t

➤ **Kushtet gjeologjike**

Territori i Bashkise Divjake ne pikpamje gjeologjik eshte indertuar nga shkembijnje te rinje ne pikpamje te moshes; shkembijnje me te vjeter jane ata te miocenit te mesem-Pliocenit N₂ dhe me te rinjte jane ata te kuaternarit Q4. Shkembijnjte qe ndertojne zonen kodrinore jane ne pergjithesi me te vjeter; ata jane te moshave pliocenike. Zonat fushore mbulohet nga depozitime te reja kuaternare por posht tyre ndodhen formacionet pliocenike, Pershkrime me te detajuara, sidomos per zonen kodrinore, si shkembijnjte me te vjeter, jepen me poshte.

- ✓ Zona kodrinore qendrore, ose kodrat e Divjakes, ndertohen nga shkembijnje te moshes pliocenit (N₂). Sipas dy tipeve; ato te pakos se poshteme dhe ato te pakos se siperme. Pakua e poshteme e formacioneve pliocenike (N_{2h}), perhapet ne anen perendimore te gjysmes veriore te kodrave te Divjakes. Ato perfaqesohen nga depozitimet e serise Helmesi qe perbehet kryesisht nga argjila me shtresa te rralla e te holla ranoresh kokervogel. Pakua e siperme e formacioneve pliocenike (N_{2r}), perhapet ne krejt pjesen tjeter te vargut kodrinor, perfaqesohet nga formacionet e suites Rogozhina e cila perbehet kryesisht nga konglomerate dhe ranore shtresetrashme me shtresezime te holla argjilash dhe alevrolite. Trashesia e shtresave konglomeratike dhe ranore luhetet zakonisht nga disa metra ne mbi 30 ose 40m. Konglomerati dhe ranoret zakonisht jane te cimentuara me material karbonatike. Trashesia e pergjithshme maksimale e formacioneve Rogozhina eshte 600-700m.
- ✓ Zona fushore lindore e cila perfshin pjesen me te madhe te fushes se Lushnjes nga lugina e Shkumbinit deri ne Kemishtaj, ndertohet kryesisht nga depozitime te reja kuaternare. Ato perfaqesohen nga aluvione te lumit Shkumbin i cili me pre ka rrjedhur neper fushen e Lushnjes ne drejtim veri-jug. Ne keto depozitime dallohen kryesisht dy pako, e poshtemja qe perfaqesohet nga zhavorre dhe e sipermeja qe perfaqesohet nga suargjila, rera dhe argjila si dhe trofe ne ish keneten e Terbufit. Trashesia e depozitimeve kuaternare rritet nga rreth 25-30m te lumit Shkumbin ne rreth 80-100m ne jug, ne Kemishtaj. Depozitimet kuaternare mbeshketen mbi formacionet pliocenike te serise Rogozhina.
- ✓ Zona fushore-lagunore perendimore e cila perfshine lagunen e Karavastase dhe siperfaqet fushore perreth saj eshte e mbushur nga depozitime te reja kuaternare te shumellojshme. Ne pjesen veriore fusha mbushet nga depozitime alubiole kokervogel (argjila deri ne rera) te lumit Shkumbin. Ne pjesen fushore rreze kodrave ka depozitime delubiale dhe ato kokervogel, ndersa gjithe zona e lagunes dhe vija bregdetare eshte e mbushur kryesisht nga depozitime detare te perfaqesuara se pari nga rera me trashesi deri ne 40-50m. Ketu perfshihen gjithe dunat detare. Ne tabanin e lagunes se Karavastase ka nje shtrese argjilore poshte se ciles vazhdonje rerat bregdetare.

- ✓ Zona fushore lindore eshte e mbushur nga depozitime kuaternare te shumellojshme. Gjate lugines se lumit Shkumbin mbizotrojne aluvionet te cilat ketu perfaqesohen kryesisht nga depozitime rerash. Ne pjesen qendrore dhe veriore te fushes takohen perzierje depozitimesh te ndryshme si suargjila, argjila dhe rera, kurse gjate bregut te detit ne nje breze me gjeresi qe luhatet nga rreth 200m deri ne mbi 1km ka depozitime rerash detare. Trashesia e depozitimeve kuaternare ne kete zone arrin deri ne 70m.

➤ **Trashegimia arkitektonike dhe historike**

Me ndarjen e re terriotoriale Bashkia e Divjakes mori ne administrim 9 Monumente Natyrore te mbrojtura nga shteti.

1. Pisha e Eger ne oazin e Divjake
2. Dushkajat e Senes
3. Godulla e Pishes
4. Vidhat ne Zharnec
5. Ishulli i Pelikanit

Ishulli i Pelikanit ndodhet ne Lagunen e Divjakes, ne lartesis rreth 0.5m mbi nivelin e detit. Eshte nje ishull mjaft interesant i formuar nga akumulimet e mbetjeve organike, ne te cilin eshte formuar nje ekosistem dhe ku dallohet nje bote shume e pasur bimore barishtore. Aty ku folezizon Pelikani kaçurrel, aty ku ka ngritur mbreterin e tij dhe qe vet ai konsiderohet si “mbreti” i Lagunes. Pelikani kaçurrel eshte nje nga banoret autoktone te Lagunes. Ai rritet e zhvillohet ne lagune nuk shtegton. Eshte nje shpend grabitqar e gjigand me peshe rreth 16kg. Pelikani kaçurrel ka ngjyre te bardhe me pulla gri, ushqehet me peshq e gjallesa te tjera deti. Nderkoh shumimi natyral i tij eshte paksa delikat sepse femra ngroh dhe çel vetem dy veze duke i depozituar ato ne Kenete. Banoret e Divjakes tregojne se para shume vitesh numri i pelikaneve arrinin rreth 500 nderkoh per shkak te bonifikimit dhe instalimit te rrjetit te tensionit te larte rrezikoj jetesen e ktij lloje te vacant shpendi. Mbijetesa e ketij shpendi te rralle kercenohet çdo dite nga njerez te cilet nuk ja dine vleren. Pelikani kaçurrel eshte nje bukuri e veçante dhe duhet qe njeezit e zones te bashkepunojne ne mbrojtjen dhe zhvillimin e llojit te tij.

6. Ishulli i Kularit

Ishulli i Kularit ndodhet prane deltes se lumit Shkumbin 0.5 m mbi nivelin e detit, i formuar si rezultat i prurjeve aluvionale te lumit. Ishulli eshte i mbuluar nga shkurret plei i eger druri i kedrit, kullotat dimerore dhe lloje te ndryshme vegjetacioni te gjelber. Aty mund te gjenden disa lloje shpendesh ujore dhe veçanterisht , pelikani Dalmat.

7. Kordoni litoral i lagunes se re te Divjakes
8. Dunat e Oazit te Divjakes

9. Gorica ne Kryekuq

Ndodhet disa dhjetra metra me ne veri te qendres se fshatit Kryekuq. Eshte e larte 10 – 12 m, gjeresi te trungut rreth 60 cm. Aty ndodhen rrenoja te nje teqeje

Parku Kombetar Divjake-Karavasta

Parku kombetar Divjake-Karavast eshte nje zone e mbrojtur ne zonen bregdetare te Shqiperise, e cila ben pjese ne Kategorine II te zonave te mbrojtura. Parku perbehet prej ekosistemeve komplekse te tilla si laguna, pylli, toka bujqesore, etj., te cilat jane shume te pasura ne biodiversitet dhe habitate natyrore. Ai ndodhet ne pjesen qendrore dhe bregun perendimor te Shqiperise dhe kufizohet ne veri nga lumi Shkumbin, kodrat e Divjakes ne Lindje, lumi Seman ne Jug dhe ne Perendim nga deti Adriatik.



Foto 8 Parku Kombetar Divjake-Karavasta

Kjo zone konsiderohet si nje zone me vlere te veçanta per natyren dhe biodiversitetin. Mjediset me kryesore te Parkut jane; laguna e Karavastase, godullat perreth saj, shtreterit e vjeter dhe te rinj te lumenjve Shkumbin dhe Seman, ujembledhesit e Terbufit dhe te Myzeqese, rezervuarat, tokat bujqesore, pyjet pergjate brigjeve te lumenjve Shkumbin e Seman, pyjet me pise mesdhetare, pyjet ne kodrat e Divjakes, pemet frutore, ullishtet, vreshtat dhe agrumet. Ky park eshte nje nga vendet e preferuara ne bregdetin ranor shqiptar per turizem detar, ekoturizem, çlodhje, kerkime e studime. Parku shquhet nga popullata te shumellojshme floristike e faunistike, endemike, subendemike, te rralla, te kercenuara e te rrezikuara per zhdukje. Laguna e Karavastase eshte pjese e listes se ligatinave me rendesi nderkombetare si nje “Zone Ramsar” sipas Konventes se Ramsarit qe prej vitit 1995. Zona e Parkut eshte vleresuar edhe zone e rrjetit Emerald sipas Konventes se Bernes, “Per konservimin e jetes se eger dhe habitateve natyrore te Europes”.


Laguna e Karavastase eshte laguna me e madhe ne Shqiperi me nje siperfaqe prej 4300 ha. Nder te tjera dhe me rendesi mjaft te madhe per kete lagune, eshte fakti se ne te gjendet pika e vetme e folezimit te Pelikanit kaçurrel (*Pelecanus crispus*) ne Shqiperi. Gjithashtu ne parkun kombetar

Divjake-Karavasta gjenden 29 lloje zvarranikesh dhe amfibesh, 25 lloje gjitaresh, 252 lloje shpendesh dhe 250 lloje bimesh. Po aq e pasur per kete zone eshte edhe flora e saj. Pylli natyror halor mesdhetar, me pishe te eger e te bute, eshte i vetmi i ketij lloji ne vendin tone ne gjendje natyrore. Zona e Parkut pershkohet nga duna ranore bregdetare, te cilat pergjithesisht jane te zhveshura nga bimesia.

Ekosistemit ia shton me shume vleren dhe prania ne te e disa bimeve endemike si Asteri (*Aster albanicus*), Salepet (*Orchis albanica*), Hidrokotili i rendomte (*Hydrocotyle vulgaris*), Fieri mashkull (*Dryopteris filix-mas*) dhe Fieri i Krojeve (*Adiantum capillus-veneris*). Fauna e ketij parku kombetar eshte po aq e larmishme dhe ne te mund te gjesh nje komunitet te rendesishem te shpendeve ujore folenizues, kryesisht te rendit te puloreve, qukapikeve, pellumbave, harabeleve, grabitqareve te dites e te nates. Ne ekosistem takohet edhe nje entomofaune e pasur karakteristike si lloje fluturash, pilivesa, mushkonja etj.


Ne Park jane te pranishem edhe nje numer i konsiderueshem zvarranikesh, breshkash toke, uji e te detit. Ne zone takohen kafshe te egra si: dhelpra (*Vulpes vulpes*), kunadhja (*Martes martes*), çakalli (*Canis aureus*), nuselalja (*Mustela nivalis*), baldosa (*Meles meles*), lunderza (*Lutra lutra*) nje gjitar globalisht i rrezikuar etj. Nga zvarraniket me te zakonshem jane: breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*), breshka e ujit (*Emys orbicularis*), breshka e detit (*Caretta caretta*), zhapiku i gjelbert (*Lacerta viridis*), gjarperi i ujit (*Natrix tessellata*), neperkat (*Vipera* sp), etj. Karavastaja dhe mjediset ujore rreth saj si dhe bregdeti jane habitate shume te rendesishme per disa lloje peshqish si ngjala (*Anguilla anguilla*), koca (*Sparus aurata*), levreku (*Dicentrarchus labrax*), qefulli (*Mugil cephalus*), aterinat (*Aterina* sp), burdullaku etj. Ne zonen e parkut mbareshtrohet edhe buallica (*Bubalus bubalis*) e cila eshte nje lloj i mbrojtur ne Shqiperi.

ZONAT E MBROJTURA



02/06/2021, 10:50:28

1:144,448



-  Monimente Natyre Pikë
-  Monimente Natyre Poligon
-  Zonat e Mbrojtura
-  Brezi_Bregdetar

Earthstar Geographics

VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Vleresimi i ndikimeve negative ne mjedis analizohet gjate fazes se funksionimit te aktivitetit "Rritje intensive e gjedhit ne nje instalim". Per vete natyren e veprimtarise impaktet negative vleresohen te jene me te larta ne fazen e funksionimit.

Vleresimi i impakteve kryhet ne baze te teknologjise qe operone ky subjekt. Ne vijim do te studjojme impaktet negative qe implementohen nga ky projekt per parametra te ndryshem mjedisore.

➤ **Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones**

Ne karakteristikat fizike nuk perfshihen ndryshime ne topografine e siperfaqes ku zhvillohet aktiviteti. Instalimet jane egzistuese dhe vete natyra e aktivitetit te rritjes intensive te gjedheve nuk ndikon ne ndryshime fizike te zones. Ky aktivitet i kryen te gjitha proceset brenda kufijeve te objektit duke mos ndikuar negativisht ne karakteristikat fizike te zones.

➤ **Ndikimet negative ne habitate dhe bodiverstetin e zones se projektit**

Ne truallin perreth objektit zona ka nje flore te tokave bujqesore te varfer ne lloje. E njejta gje mund te thuhet per specie te faunes qe gjinden ne zonen e projektit qe perfaqesohen kryesisht nga reptile dhe zogjte, specie jo me status te veçante ose te mbrojtur. Duke qene se objekti stalles eshte i ndertuar dhe aktiviteti nuk shoqerohet me zhurma dhe shfrytezim toke, zhvillimi i ketij projekti nuk ndikon aspak ne biodiversitetin e tokes. Perkundrazi mbetjet e jashteqitjeve qe do te gjenerohen nga ky aktivitet pas trajtimit paraprak te tyre do te perdoren per pleherimin e tokes qe mbillet nga aktiviteti dhe do tu shperndahet fermereve ne zone.

➤ **Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve**

▪ **Shkarkimet ne ajer**

Zhvillimi i aktivitetit te rritjes intensive te gjedhit nuk gjenoren shkarkime ne ajer. Nga ky aktivitet gjenerohen vetem aroma te pa kendshme qe vijne nga jashteqitja e kafsheve. Gjithsesi subjekti bene ventilimin e objektit ne menyre periodike duke i minimizuar keto aroma. Keto aroma nuk jane shqetsuese per banoret pasi objekti ndodhet ne nje distance 1.5 km nga objekti me i afert. Keto aroma behen te besdisshme vetem per punonjesit e subjektit.

▪ **Shkarkimet ne uji**

Ne nje distance prej 3 km ndodhet laguna e Karavastas. Ky aktivitet nuk ndikon ne prishjen e cilesise se ujrave perreth pasi kryhet brenda kontureve te siperfaqes se truallit ku eshte instaluar aktiviteti i rritjes intensive te gjedhit. Gjithashtu sheshi i obejktit eshte i shtruar me beton i cili mbron

cilesine e ujrave nentokesor nga filtrimi i lendeve ne impiant. Do te kete ndikim te cilesise se ujrave vetem ne ato raste kur kompania shkarkon ujra ne mjediset ujore te cilet nuk permbushin kushtet e cilesise se ujrave te shkarkimit. Ky aktivitet nuk do te gjeneroj sasira te medha uji. Procesi teknologjik nuk kerkon perdorim uji. Te vetme sasi ujore qe do te gjenerohen jane ato nga ambientet higjeno-sanitare te cilat do te shkarkohen ne gropen septike qe eshte ndertuar nga subjekti sipas kushteve te caktuara teknike. Gjithashtu ujrat e pastrimit grumbullohen nepermjet pjerresis se sheshit dhe shkarkohen ne gropen e plehut ku behet trajtimi i jahteqitjeve te kafsheve per tu perdorur me pas per pleherimin e tokes.

➤ **Prodhimi i mbetjeve**

Mbetjet qe gjenerohen nga ky aktivitet jane:

- Mbetjet me natyre urbane qe gjenerohen nga aktiviteti jetesor i punonjesve ku perfshihen plastika, qelqi, metali, etj. Keto mbetje grumbullohen nepermjet koshave qe ndodhen ne ambientet e aktiviteti dhe prej andej do te transportohen drejt vendit te depozitimit te mbetjeve urbane.
- Mbetjet nga jashteqitja e kafsheve, ato pastrohen me anen e nje rraskete dhe depozitohen ne gropen e depozitimit te plehut, asgjesimi i plehut kryhet ne menyre shume efektive duke pleherosur tokat per qellim rritjen e kapaciteteve prodhuese te tokave bujqesore.

➤ **Emetimi i zhurmave**

Nga zhvillimi i proceseve te rritjes intensive te gjedhit nuk ka emetime te zhurmave. Te vetme zhurma jane ato qe gjenerohen nga makinat e transportit te qumeshtit te cilet e transportojne ne destinacionin e kerkuar.

➤ **Ndikimet sociale te projektit**

▪ **Perdorimi i tokes**

Implementimi i projektit nuk sjelle tjetersim te perdorimit tokes pasi objekti dhe instalimet jane egzistuese dhe nuk ka nevoj per nderhyrje te metejshme. Ky fakt nuk sjell ndikime ne uljen e tokave bujqesore pasi kjo eshte prone private. Ne zone ndodhen kanale kulluese te cilat bejne drenazhin e tokes, duke shmangur keshtu dukurin e erozionit.

▪ **Zhurmat**

Ne fazen e funksionimit burimet e zhurmes vijne vetem nga automjetet e transportit te qumeshtit te prodhuar ne ferme. Duke qene se qendrat e baanuara ndodhen ne nje distance te larget nga objekti, ky aktivitet nuk eshte shqetesues per banoret e zones.

▪ Emetimi i pluhrave dhe grimcave ne ajer

Do te kete emetime te gazeve nga djegja e karburantit ne motoret e automjeteve qe do te kryejne transportin e qumshit apo sjelljen e produkteve te nevpjshme ne ferme. Keto emetime do te jene brenda normave te lejuara.

Gjithashtu do te kemi dhe pranin e aromave te pa kendshme nga jashteqitjet e kafsheve. Por duke gene se ky objekt eshte ndertuar ne periferi te qytetit te Divjakes, keto aroma jane te paperfillshme. Shqetesuese jane vetem per punetoret e fermes.

➤ Aksidentet e mundshme me pasoja ne mjedis

Duke gene se ne kete instalim proceset e rritjes intensive te gjedhit nuk perdorin kimikate apo lende te ndryshme toksike, nuk do te kete aksidente te cilat shakaktojne pasoja ne mjedis.

Kontaminimi i tokes nga funksionimi normal i veprimtarise eshte zero. Pasoja ne cilesine e tokes do te kete ne rast te keqmenaxhimit te mbetjeve (jashteqitjeve te kafsheve) qe gjenerohen nga aktiviteti dhe nga rrjedhjet aksidentale te karburanteve te automjeteve qe bejne te mundur transportin e lendeve te para dhe qumeshtit. Kompania siguron funksionim te kontrolluar te aktivitetit me qellim shmangien e mundesise per kontaminimin e tokes.

Prishja e cilesise se ajrit

Ajri eshte nje nga parametrat me te rendesihem te cilesise se mjedisit dhe kontaminimi i tij do te sillte ndryshime te medha ne cilesine e jetes. Ekziston mundesia e aksidenteve me pasoja ne cilesine e ajrit. Shkarkimet e pakontrolluara te mbetjeve ne mjedis te hapur jane nje tjetër burim i emtimit te gazeve ne ajer.

Tjetersim i habitatit

Mundesia e aksidenteve te cilat sjellin tjetersim te habitatit ekzistues jane thuajse zero. Kjo do te ndodh vetem ne rast te shkarkimeve madhore te mbetjeve ne mjedis perreth.

Prani te zjarrit

Prani te zjarrit mund te kemi vetem si pasoj e shendijave elektrike, por subjekti do te mare masa duke vendosur ne ambientet e stalles pajisje kundra zjarrit.

MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Identifikimi i masave per te eliminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis

a) Planifikimi i zones

Zhvillimi i aktivitetit eshte parashikuar te behet sipas projektit duke ruajtur radhen e puneve grumbullimin e mbetjeve, diferencimin e tyre sipas perberjes dhe transportin e tyre drejt destinacionit perkates.

Rreth ketij objekti, eshte parashikuar dhe mbjellja e disa pemeve dekorative per zbuturimin dhe pastrimin e ambientit te aktivitetit.

b) Masat teknike

Per nje ecuri sa me te mire te puneve ne impiantin e diferencimit te mbetjeve, personi fizik parashikon cdo vit te kryej punimet e meposhtme:

- Remot te plote te makinerive qe kryejne procesin e pergatitjes se ushqimit dhe mjelejes se gjedhit.
- Pastrim, lysterje dhe riparim te mjediseve te brendshme dhe te jashteme te stalles.
- Sistemime e rregullime dhe mbjellje fidanesh te rinj ne pjeset anesore te sheshit.

c) Masat estetike dhe ekologjike

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti subjekti do te kryej proceset e meposhtme:

- Ruajtjen e rrethimit te objektit
- Sistemimin e mbetjeve qe dalin nga procesi i rritjes intensive te gjedhit dhe depozitimin e tyre ne vendin e caktuar ne objekt.
- Levizjen e automjeteve te transportit brenda objektit ne menyre te kontrolluar dhe pa krijuar remuje ne oborr.
- Krijimin e kushteve te pershtatshme per te mbjelle dhe kultivuar bime dhe peme te ndryshme.

d) Masat konkrete per administrimin e mbetjeve te ngurta

Aktiviteti i rritjes intensive te gjedhit ne nje instalim, per administrimin e mbetjeve qe do te gjenerohen, duhet te marre keto masa:

- Mbetjet dalin nga punonjesit, duhet te largohen ne menyre korekte nga ambientet e punes dhe te dergohen drejt destinacionit perkates.
- Mbetjet me natyre organike qe do te dalin gjate procesit te rritjes intensive te gjedhit (jashteqitja e kafsheve) duhen te grumbullohen dhe te depozitohen ne gropen e plehut qe ndodhet ne ambientet e aktivitetit.

e) Masat konkrete per mbrojtjen e cilesise se ajrit

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emeton aktiviteti i rritjes intensive te gjedhit te jene vazhdimisht brenda normave te lejuara duhet te merren keto masa keto masa:

- Ambientet rreth e rrotull aktivitetit duhet te sperkaten me uje ne menyre te tille qe kur te vijne dhe te largohen makinat e transportit te lendes se pare dhe qumeshtit para objektit te aktivitetit te mos ngrihen pluhura (keto jane te vetme pluhura qe gjenerohen nga aktiviteti).
- Te kryhet ventilimi i ambjenteve te stallles ne menyre periodike per te shmangur aromat e pa kendeshme.
- Te mbillet nje breze i gjelber perreth parceles se aktivitetit duke izoluar objektin nga pjesa tjeter e zones, dhe per pastrimin e ajrit nga pluhurat dhe aroma e pakendeshme.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbatuese

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permirsimi i vazhdueshem, sipas kushteve teknike te punes ne zbatim te projektit, qe do te coje perfundimisht perfitimin e pamjeve te parashikuar ne projekt me sipërfaqe te brendshme te sistemuara dhe me oborr te gjelberuar aty ku do te kete hapsira te lira.

Plani i emergjencave

Plani i emergjencave eshte nje nder planet kryesore me qellim parandalimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve, komunitetit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Personeli i ketij projekti duhet te njohe mire te gjitha proceset qe kryhen ne kete projekt ne menyre qe te arrije te kuptoje situaten, shkaqet dhe te jete i pergatitur per menaxhimin e avarive apo aksidenteve. Ne rast se gjendemi para nje aksidenti personat me te afert duhet te japin shenjen e alarmit. Ne varesi te llojit dhe madhesis se aksidentit do te kryhet izolimi.

Masat per parandalimin e avarive dhe aksidenteve ne frontin e punes jane:

- Perdorimi i mjeteve dhe paisjeve te cilat jane ne gjendje te mire teknike
- Servisim periodik i mjeteve dhe instalimeve te tjera ne frontin e punes
- Çdo person para se te nisi punen ne kete projekt ti nenshtrohet trajnimit per te njohur gjitha procesin teknologjik, per tu njohur me rrezikun e aksidenteve dhe reagimin e tij ne cdo rast emergjent.
- Ne objekt te ndertohet kendi i ndihmes se shpejte dhe te jete i njohur nga te gjitha personat e punesuar.
- Ne objekt te vendosen tabela/njoftime ku tregohen pikat kyçe te rrezikut, te publikohen numrat e kontaktit te supervisorit te emergjencave.
- Zona te jete e rrethuar per te evituar hyrjen e personave te pa autorizuar.

- Te jete ndertuar sistemi i tokezimit

Trainimi i Personelit

- Trainimi do te mbuloje aspektet e shendetit dhe sigurise gjate kryerjes se proceseve te punes. Trainimi mjedisor do ti referohet kushteve aktuale mjedisore, ndikimeve potenciale mjedisore te punes qe do te behet dhe zbatimit te masave specifike parandaluese per eliminimin apo minimizimin e ndikimeve negative.
- Nje plan trainimi do te zhvillohet per te siguruar se personeli perkates ka marre trainimin e duhur dhe kompetencat per kryerjen e punes se tij.

Subjekti eshte i detyruar qe ne rast aksidentesh te njoftoje institucionet perkatese per menaxhimin e situatave me qellim zvogelimin e impakteve mjedisore dhe rrezikut qe mund te preke jeten e punonjesve apo dhe banoreve.